



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË**  
**EITI ALBANIA**  
**SEKRETARIATI I NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE**

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI**  
**(SHËRBIME KONSULENCE– PËRZGJEDHJA E INDIVIDËVE)**

Republika e Shqipërisë  
Ministria e Energjisë dhe Industrisë  
Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse  
Granti Nr.: TF0A1769

**Titulli i paketës:** Përzgjedhja e një Konsulenti Individual si Zëdhënës i Marrëdhënieve me Publikun të EITI Shqipëri për vitin 2017.  
**Nr. i Referencës:** ALBEITI/IC/002

Kjo Kërkesë për Shprehje Interesi publikohet pas Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit për këtë projekt, i publikuar në Development Business online No. WB 2414-05/16 of May 27, 2016.

Republika e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore për llogari të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Albania) dhe synon të përdorë një pjesë të financimit për shërbime konsulence.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë përzgjedhjen e një konsulenti individual si zëdhënës i i Marrëdhënieve me Publikun të EITI Shqipëri për vitin 2017. Objektivi kryesor është që të rrisë ndërgjegjësimin, të krijojë një imazh të EITI në Shqipëri nga perspektiva e gazetarisë ekonomike, dhe të gjenerojë vëmendje, debat pozitiv dhe diskutime të tilla që do të nxisin reforma. Zëdhënësi i Marrëdhënieve me Publikun ka përgjegjësinë të përfaqësojë organizatën në evente, ekspozita dhe ngjarje të tjera promovionale. Ai / ajo zakonisht do të shfaqet në mediat rajonale dhe lokale, si revista, shfaqje publike, shfaqje televizive, etj, dhe për të promovuar parimet e EITI, transparencën, përgjegjshmërinë, shkëmbimin e informacionit dhe diskutime. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë afërsisht 365 ditë nga nënshkrimi i Kontratës.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë fton konsulentë individualë të përshtatshëm (“Konsulentë”) të shprehin interesin e tyre në ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të japin informacion që paraqet kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencën e përshtatshme për të kryer Shërbimet. Kriteret e përfshirjes në listën e shkurtër janë:

- Diplomë universitare në gazetari, me drejtim ose kualifikime në ekonomi, inxhinieri ose administrim biznesi;
- Me aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërpersonale. Përveç kësaj, konsulenti duhet të ketë një personalitet tërheqës dhe përgatitje profesionale. Konsulenti nuk duhet të hezitojë për të udhëtuar në vend apo jashtë vendit.

- Të paktën 5 vite eksperiencë profesionale në fushën e gazetarisë, TV, etj.;
- Njohuri të gjuhës angleze;

Konsulentëve të interesuar iu kërkohet t'i kushtojnë vëmendje paragrafit 1.9 të Udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas Huave të IBRD dhe Kredive dhe Granteve të IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore, të datës Janar 2011* ("Udhëzimet për Konsulentët"), që përcakton poliikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e Konsulentëve Individualë (IC) të përcaktuar në Udhëzimet e Konsulentëve.

Më shumë informacion mund të merret në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08.00 deri 16.30 nga e hëna deri të enjten dhe 08.30 deri 14.00 të premtën.

Shprehjet e interesit mund të dorëzohen zyrtarisht në adresën e mëposhtme (personalisht, ose me postë, ose me e-mail) deri më **05 Janar 2017 ora 16:30**.

*Ministria e Energjisë dhe Industrisë*

*Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Albania)*

*Në vëmendje të: Znj. Dorina Çinari, Drejtuese e Sekretariatit EITI Albania*

*Blv. Zhan D'Ark, Godina 3, mbrapa Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kati V,*

*Zyra Nr. 406, Tiranë*

*E-mail: Dorina.Cinari@albeiti.gov.al*

